



## NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i per gjithshem- dega në Novobërdë, përmes gjyqtarit të vetëm Hasan Sadiku, me proqesmbajsen Fikrije Rexhepi, në qështjen penale kundër të akuzuari Sh. A. nga Gjilani, për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par. 1 lidhur me nën parag. 1.3 të KPRK-ës, sipas aktakuzës, së Prokuroris Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm. PP.II.nr.863/2017 të dates 06.06.2017, të cilën e ka përfaqqsuar Prokurorja e shtetit Bahtije Ademi, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dat. 22.06.2017 ndërsa me date 23.06.2017, publikisht komunikoi këtë,

### A K T G J Y K I M

I akuzuari Sh. A., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati , dhe e nëna, , e lindur, , i lindur . në Gjilan, me vendbanin në rru. " " nr. 76. Shqiptarë, shtetas i R.Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, pranar i SHPK "Verona" i martuar, baba e tre fëmijve, gjendjes së varfyr ekonomike, më pare i pa gjykuar dhe nuk zhvillohet procedur tjetër penale ndaj në arrest shtëpiak nga data 13.06 deri 23.06.2017.

### Eshtë fajtor

Sepse më datë 22.05.2017 rrëth orës 23:30 min. në fushën sportive "Tifozët kuq e zi" në rrugën qarkore, mbrapa "Al Petrollit" i akuzuari i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarit A. M. nga , në atë mënyrë që deri sa kanë qenë duke luajtur futboll fillimishtë ka ardhur deri te mosmarrëveshja vërbale mes tyre, e më pas edhe deri te kontakti i tyre fizik, me që raste i akuzuari e godet me kokë të dëmtuarin në hundë dhe në pjesën e syrit, dhe i shkaton lëndime të rënda trupore- thyrje e hundës, i cili për shkak të lëndimeve të pësuara tani i dëmtari, detyrohet të kërkoi ndihmë mjeksore në Emergjencën e Spitalit Regional në Gjilan, sipas raportit meksor nr. 10594 të datës 22.05.2017.

Me qka ka kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 paragrafi , 1 nën parag.1.3 të KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 41, 51, 64, 73, 74, 75, 76 të KPK-ës, si dhe nenit 391 të KPRK-së,

### **E GJYKON**

Me dënim burgu secilin në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë )muajve, të cilin dënim të akuzuarit nuk do ta mbajnë, ne qofte se në afat prej 18 (tetëmbedhjet) muajve ,nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonje vepër tjetër penale, në të kundërtën dënim i me kusht ka për të iu revokuar.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 25 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit ,nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

I dëmtuarit, ~~Sh. Al. A.~~ realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

### **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i per gjithshem -me aktakuzën PP. II.nr. 863/2017 të dates 06.06.2017, e ka akuzuar Sh. Al. , për shkak te vepres penale lëndim I rëndë trupor nga neni 189 para 1 nën par.1.3 te KPRK-se.*

*Prokurorja e shtetit Bahtuje Ademi, ne seancën fillestare ka deklaruar: se mbetem pranë aktakuzës së ushtruar me shkrim, dhe propozoi që të akuzuarit të shpallën fajtor dhe të ju shqiptohet denimi meritor sipas kodit penal, gjithnjë duke i marrë per bazë lehtësuese dhe ato rënduese.*

*I akuzuari Sh. ~~Al.~~ ne shqyrtimin fillesttar ka deklaruar se: e pranoj e fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, shprehim keqardhje dhe pendohem pë kryerjen e kësaj vepre penale dhe i premtojmë gjykatës se në të ardhmen kurrë nuk do të biem ndesh me ligjin, se këtë pranim e bëjë në mënyrë vullnetare edhe pse jamë i injostuar për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë.*

*I dëmtuari*, në seancën fillestare deklaroj: procedures penale ndaj të akuzuarit i bashkangjitem dhe nga i njejtë e kërkoj kompenzimin e demit moral dhe material.

Meqense i akuzuarii ne seancën fillestare të kësaj qështje penale e ka pranuar fajesinë për të gjitha pikat e aktakuzës e me këtë sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjendja faktike në këtë qështje penale nuk është kontestuese, sepse perpos pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit një pranim i tillë ka edhe mbeshtetje në provat e grumbulluara te cilat gjenden ne shkresat e lendet dhe se i akuzuari vullnetarisht e ka pranuar fajesinë, se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore, andaj gjykata e vazhdoj procesin ndaj të njëjtit me shqiptimin e dënimit pa shkuar fare në shqyrtim gjyqesor kështu duke vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 248 paragrafi 4 te KPPK-se, dhe pa fjalë përfundimtare.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të akuzuarin Sh. A. gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrëthanat të cilat kanë ndikim që dënimini të jetë më i butë apo më i rendë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së. Keshtu si rrëthanë lehtësuese gjykata pati parasysh sjelljen korrekte para gjykatës, pranimin e fajësisë qka do të thotë se të akuzuari ka pranuar të jetë bashkepunues, është penduar dhe ka kërkuar falje per vepren e kryer penale, si dhe premtimin se ne te ardhmen nuk do te bien ndesh me ligjin, gjendjen e varfér ekonomike, se është babba i tre fëmijve është hera e pare që ka rën ndesh me ligjin. Ndërsa si rrëthanë rënduese për të akuzuarin gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërin shoqërore dashjen për kryerjen e vepërs penale dhe pasojen e shkaktuar, nga kjo vepër penale sepse i akuzuari me kokë e ka goditur te dëmtuarin në hundë duke ia krisur ashtin e hundës, lëndim ky i cilësuar si lëndim i rëndë trupor

Andaj gjykata është e bindur se edhe me dënimet e shqiptuara për të akuzuarin, do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të akuzuarin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejnë vepra tjera penale dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përbahen nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për shpenzimet e procedure penale si dhe paushallin gjyqosor është mbështetur në dispozitën e nenit 453 parag. 1, lidhur me nenin 450 parag. 1 nën parag 2 e 6 të KPPK-së.

Vendimin mbi realizimin e kërkësën pasurore juridike Gjykata, e bazoi në dispozitën e nenit 463 parag. 1 të KPPK-ës.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë**

**- Departamenti i pergjithshem**

**P.nr. 37/2017 më date 23.06.2017**

*Gjyqtari,  
Hasan Sadiku*

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën Apelit në Prishtinë, afat prej 15 ditësh nga Dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa dorzohet përmes kësaj gjykate.

